



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 656 / 10 Prot.

Tiranë, më 28 / 02 / 2023

**Drejtuar : MINISTRISË SË FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT**

TIRANË

Lënda: Raporti i Monitorimit të Buxhetit për vitin 2022.

Në mbështetje të Ligjit nr.115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, akteve normative të vitit 2022, në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar , udhëzimit plotësues nr.1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, lutemi gjeni bashkëlidhur Raportin e Monitorimit të Buxhetit të vitit 2022 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Raporti i monitorimit i për vitin 2022 krahas analizës së shpenzimeve buxhetore në nivel programi përmban dhe një analizë të objektivave institucionale referuar performancës buxhetore të orientuar drejt rezultateve.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Valbona GAXHA



PËRMBAJTJA		Faqe
Hyrje		2
Raport i monitorimit të buxhetit të KLSH-së për vitin 2022		2-3
Analiza e realizimit të buxhetit të KLSH-së për vitin 2022		3-7
Analiza e objektivave institucionale të KLSH-së, referuar buxhetit të orientuar në rezultate.		7-13
Aneksi Nr. 1	Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve.	14
Aneksi Nr. 2	Raporti i shpenzimeve të Programit sipas artikujve buxhetorë.	15
Aneksi Nr. 3	Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës /produkteve të programit.	16
Aneksi Nr. 4	Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit.	17
Aneksi Nr. 5	Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe të huaj.	18

HYRJE

KLSH ka kryer monitorimin e buxhetit të vitit 2022, nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të KLSH-së të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

Në vijimësi dhe strukturat respektive të KLSH-së kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetore më qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e politikës së programit të KLSH-së të përfshirë në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022.

Në mbështetje të Ligjit nr.115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Aktit Normativ, nr. 3, datë 12.03.2022 dhe Aktit Normativ, nr. 17, datë 01.12.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin 115/2021 “ Për buxhetin e vitit 2022”, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.07.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, për periudhën ushtrimore 2022, performanca e realizimit të buxhetit, paraqitet si më poshtë:

PROGRAMI 01120 “VEPRIMTARI AUDITUESE E KLSH-së”

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese e KLSH-së”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2022-2024 dhe është në funksion të kësaj Deklarate.

Politika buxhetore e KLSH-së është fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave, si dhe prioritetëve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2018-2022, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe të BE-së të përcaktuara në MSA-në e Shqipëri-BE dhe të monitoruara në kuadrin e Integrimit Evropian.

Përgjatë vitit 2022 KLSH vijon me ushtrimin e veprimtarisë institucionale në përmbushje të objektivave prioritare të përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022, objektivat e KLSH vijnë të jenë:

- Rritja e impaktit të punës audituese me fokus në 6 E-të (ekonomicitetin, eficiencën, efektivitetin, etikën, mjedisin dhe energjinë);
 - Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse;
 - Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit.
- Për sa i përket kërkesave buxhetore, duke vlerësuar dhe gjendjen aktuale financiare, menaxhimi i buxhetit është fokusuar në financimin e shpenzimeve në funksion të përmbushjes së objektivave prioritare strategjike që KLSH të programuara në harkun kohor 2022-2024 në planin strategjik institucional në drejtimet e mëposhtme:
- Kryerja e auditimit financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit (certifikimi i pasqyrave financiare) dhe shtimi i numrit të auditimeve financiare.
 - Fokusi në rritje drejt auditimit të performances,
 - Konsolidimi i Auditimit të Përputhshmërisë vlerësuar sipas kërkesave ISSAI-ve.
 - Thellimi në auditimin e teknologjisë së informacionit shtimi i numrit të auditimeve IT dhe konsolidimi i cilësisë nëpërmjet zbatimit të Standarteve Ndërkombëtare ISSAI.

- Përmirësimin e metodologjive/manualëve të auditimit, duke zhvilluar dhe metodologji të veçanta, si ajo e auditimit të mashtrimit financiar, integritetit dhe etikës.
- Nxitja dhe promovimi i vlerave të larta profesionale të audituesve nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve dhe optimizimit të kapaciteteve profesionale.
- Zbatimi i standardeve profesionale nëpërmjet zhvillimit të metodologjive dhe standardeve profesionale të aplikueshme në përputhje me praktikën më të mirë të komunitetit të INTOSAI-t.
- Zhvillimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

“RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE PËR VITIN 2022”

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Aktit Normativ, nr. 3, datë 12.03.2022 dhe Aktit Normativ, nr. 17, datë 01.12.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin 115/2021 “ Për buxhetin e vitit 2022”, është bërë miratimi i çeljes dhe rishikimit të fondeve buxhetore për vitin 2022, për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas zërave për vitin 2022, paraqiten si më poshtë:

Artikulli	Programi	Fakti 2021	PBA 2022	Plan Fillestar V. 2022	Plan i Rishikuar AN 2022	Plan i Rishikuar AN 2022	Fakti Viti 2022	Në mijë lekë	
								Diferenca	%
600	Paga	247,281	269,000	319,000	311,025	294,025	290,957	-3,068	99%
601	Sigurime Shoqërore	40,073	42,000	42,000	40,950	47,950	47,126	-824	98%
602-606	Mallra dhe Shërbime të Tjera	52,927	103,960	105,560	95,179	85,479	72,158	-13,320	84%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	340,281	414,960	466,560	447,154	427,454	410,241	-17,213	96%
231	Kapitale të Trupëzuara	7,586	15,000	20,000	20,000	14,000	13,032	-968	93%
230	Kapitale të pa Trupëzuara					6,000	4,291	-1,709	72%
Nen -Totali	Shpenzime F/Brendshëm	7,586	15,000	20,000	20,000	20,000	17,323	-2,677	87%
230	Kapitale të Trupëzuara	1,115	0	24,000	24,000	24,000	0	-24,000	
Nen -Totali	Kapitale F/ Huaj	1,115	0	24,000	24,000	24,000	0	-24,000	0
Totali	Shpenzime Kapitalë	8,701	15,000	44,000	44,000	44,000	17,323	-26,677	
Totali	(Korrente + Kapitalë)	348,982	429,960	510,560	491,154	471,454	427,564	-43,890	91%

ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË KLSH-SË PËR VITIN 2022

Bazuar në Ligjin 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” KLSH për vitin 2022 u miratua fondi në total në vlerën **510,560 mijë lekë** duke përfshirë edhe vlerën për 1,600 mijë lekë nga fondi i veçantë për vitin 2022.

-Me Aktin Normativ, nr. 3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin 115/2021 “ Për buxhetin e vitit 2022”, buxheti i KLSH-së, është pakësuar në vlerën për 19,406 mijë lekë dhe konkretisht në zërin “Paga dhe Sigurime” për vlerën 9,025 mijë lekë dhe në zërin “mallra dhe shërbime” në vlerën për 10,381 mijë lekë duke kaluar kështu në vlerën totale për **489,554 mijë lekë** ndërkohë që numri i miratuar i punonjësve nuk ka ndryshuar, pra 233 punonjës të miratuar.

-Me Aktin Normativ, nr. 17, datë 01.12.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin 115/2021 “ Për buxhetin e vitit 2022”, buxheti i KLSH-së, është pakësuar në vlerën për 20,700 mijë lekë dhe konkretisht në zërin “Paga dhe Sigurime” për vlerën 10,000 mijë lekë dhe në zërin “mallra dhe shërbime” në vlerën për 10,700 mijë lekë.

-Në zbatim të VKM nr. 898 datë 29.12.2022 “Mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë

publik për zbutjen e impaktit të krizës ” nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për institucionin tonë janë akorduar fondet buxhetore për shpenzimet operative në vlerën për 1,000 mijë lekë duke kaluar kështu në vlerën totale për **471,454 mijë lekë** ndërkohë që numri i miratuar i punonjësve nuk ka ndryshuar, pra **233 punonjës** të miratuar.

Për vitin 2022, buxheti i planifikuar në masën për **471,454 mijë lekë** dukë përfshirë edhe Financimin e Huaj, është realizuar në vlerën për **427,564 mijë lekë** ose realizuar në masën 91 %.

1- Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore. Llogaria 600-601.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2022 në Ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, për zërin “Paga dhe Sigurime ” është në vlerën për 361,000 mijë lekë. Me Aktin Normativ, nr. 3, datë 12.03.2022, ky zë, është pakësuar në vlerën për 9,025 mijë lekë dhe me Normativ, nr. 17, datë 01.12.2022. “Për disa ndryshime në Ligjin 115/2021 “ Për buxhetin e vitit 2022” është pakësuar në vlerën për 10,000 lekë kaluar kështu në vlerën totale për 341,975 mijë lekë.

Për vitin 2022, buxheti i planifikuar në masën për **341,975 mijë lekë** është realizuar në vlerën për **338,083 mijë lekë** ose realizuar në masën 99 %.

Shuma e shpenzuar në zërin Shpenzime Personeli, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar konform shkresave dhe kontratave të nënshkruara me ta.

2- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602.


Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2022 në Ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, për zërin shpenzime operative, është në vlerën për **103,960 mijë lekë**, ose 20 % e planit buxhetor të vitit 2022.

Për vitin 2022, fondi i shpenzimeve sipas Aktit Normativ, nr. nr. 3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, është pakësuar në vlerën për 10,381 mijë lekë dhe me Normativ, nr. 17, datë 01.12.2022. “Për disa ndryshime në Ligjin 115/2021 “ Për buxhetin e vitit 2022” është pakësuar në vlerën për 10,700 lekë kaluar kështu në vlerën totale për **82,729 mijë lekë**.

Plani për vitin 2022, në vlerën për 82,729 mijë lekë është realizuar në vlerën për 69,485 mijë lekë ose **realizuar në masën 84%** ose me një mosrealizim për 13,244 mijë lekë.

Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si shpenzime për shërbimin e sigurisë, drita, ujë, telefon etj. Një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet operative e zënë shpenzimet për udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit në vlerën për 45,515 mijë lekë dhe që përfaqësojnë 66% të shpenzimeve faktike të këtij zëri.

Grafiku 1, në vijim paraqet shpenzimet faktike për mallra dhe shërbime sipas zërave.



Aktualisht, për vitin 2022, KLSH , ka realizuar disa procedura prokurimi në lidhje me:

-Rinovim suporti të licenca të Fireëall dhe E-Mail Security në vlerën për 1,631 mijë lekë. Platforma informatike që përdor Kontrolli i Lartë i Shtetit, është e ngritur bazuar në teknologjinë e virtualizimit. 3 server fizikë janë hostues të 12 makinave virtuale përmes të cilave kryhet menaxhimi i të gjithë shërbimeve teknologjike të nevojshme për plotësimin e kërkesave dhe nevojave nga ana informatike të institucionit. Këta servera mbrohen përmes pajisjes Fireëall e cila ka një licencë përkatëse suporti i të cilës ka afat kohor 1-vjeçar. Gjithashtu, në infrastrukturën informatike të KLSH, është implementuar një softëare për mbrojtjen e komunikimit elektronik (e-maile) e cila gjithashtu funksionon nën një licencë. Prokurimi i rinovimit të licencave të sipërpërmendura i ka shërbyer KLSH-së për funksionimin optimal të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, rritjen e sigurisë së rrjetit si dhe lehtësimin e punës së përdoruesve të infrastrukturës teknologjike të KLSH-së.

-Blerje shërbim interneti për institucionin, mirëmbajtje ashensori, sistem alarmi, shërbim automjetesh, shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, materiale zyre, materiale pastrimi dhe disinfektimi etj.

3- Transferta korrente dhe të huaja. Llogaria 605.

Për periudhën raportuese 2022, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAT, në shumën 120 mijë lekë nga 150 mijë lekë të planifikuara.

4- Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606.

Gjatë periudhës ushtrimore 2022, është dhënë Fond i Veçantë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vlerën 1,600 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundjeje. Në zbatim të VKM nr. 898 datë 29.12.2022 “Mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës ” nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për institucionin tonë janë akorduar fondet buxhetore për shpenzimet operative në vlerën për 1,000 mijë lekë.

Shpenzimet e planifikuara në masën për 2,600 mijë lekë në llogarinë 606, janë shpenzuar në vlerën për 356 mijë për daljen e punonjësve në pension, rastet e fatkeqësisë dhe sëmundjeje dhe në vlerën për 2,148 mijë lekë për pagesën e mbështetjes financiare të menjëhershme të punonjësve të institucionit.

5- Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 230-231.

Bazuar në Ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale është në shumën 44,000 mijë lekë, nga të cilat 20,000 mijë lekë

investime me Financim të Brendshëm dhe 24,000 mijë lekë për investime kapitale me Financim të Huaj.

A-Financim i Brendshëm.

Bazuar në Ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale me Financim të Brendshëm në artikullin 230 dhe 231 është miratuar në vlerën **20,000 mijë lekë** dhe është parashikuar për zbatimin e projekteve si në vijim:

Kodi I projekt	Përshkrimi	Plani Vjetor	Plani Rishikuar	Në mijë lekë	
				Realizimi 2022	%
M240002	Blerje automjete	9,700	8,700	8,580	99%
M240009	Blerje pajisje kompjuterike	3,000	3,000	2,580	86%
M240003	Rikonstruksion Godina	1,600	1,600	1,203	75%
M240010	Blerje pajisje zyre	700	700	668	95%
19AA402	Kosto Lokale	5,000	6,000	4,291	72%
		20,000	20,000	17,323	87%

Realizimi i shpenzimeve kapitale me Financim të Brendshëm në vlerën për 17,323 mijë lekë për vitin 2022, krahasuar me buxhetin e planifikuar, është në masën 87 %.

-Blerje automjeti, projekt i ri i realizuar në vlerën për 8,580 mijë lekë nga 8,700 mijë lekë të planifikuara erdhi si domosdoshmëri e rritjes së numrit të audituesve.

-Rikonstruksioni i ambienteve të brendshme të KLSH-së, projekt në vazhdim nga viti 2021 është realizuar në vlerën për 1,203 mijë lekë. Rikonstruksioni i ambienteve të brendshme erdhi si domosdoshmëri pasi në vitin 2021, me kërkesë të KLSH-së, numri i audituesve u rrit në 218 punonjës dhe sipas Ligjit të buxhetit të vitit 2022, numri i punonjësve të miratuar është **233 auditues**.

-Blerje pajisje zyre, projekt i ri i realizuar në vlerën për 668 mijë lekë nga 700 mijë lekë të planifikuara erdhi si domosdoshmëri e rritjes së numrit të audituesve.

-Kosto lokale është realizuar në vlerën për 4,291 mijë lekë. Drejtoria e Fondit Kombëtar me shkresën nr. 4146, datë 01.03.2021 protokolluar në KLSH nr. 318, datë 03.03.2021, ka përcjellë kërkesën për transferimin e shumës prej 54,141.36 Euro në llogarinë e Fondit Kombëtar. Kjo shumë lidhet me fondet e financuara nga Bashkimi Evropian për projektin e binjakëzimit “*Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm*”. Ky projekt është implementuar në KLSH në periudhën 16 mars 2016-13 korrik 2018 dhe është financua nga Bashkimi Evropian në vlerën 2 milion euro dhe 100 mijë euro nga Buxheti i Shtetit. Pas përfundimit të implementimit të projektit nga Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Akredituar nga BE është kryer auditimi edhe për këtë projekt duke lënë rekomandim për CFCU-së (Centrale Finance and Contracting Unit), strukturë e Ministrisë së Financave “*Kontrata e financuar vetëm nga kontributi i BE-së duhet të rillogaritët në përputhje me parimin e bashkëfinancimit të përbashkët dhe pjesa e lidhur me Kontributin Kombëtar në përputhje me marrëveshjen financiare do të rimbursohet nga buxheti kombëtar*”.

B-Financim i Huaj

Bazuar në Ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale me Financim të Huaj në artikullin 231 është miratuar në vlerën **24,000 mijë lekë** dhe është parashikuar për zbatimin e projektit, “*Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri*”. Në muajin Tetor të vitit 2022, KLSH, ka realizuar me sukses procedurën e prokurimit dhe ka lidhur kontratën me operatorët ekonomikë me qëllim realizimin e këtij projekti investimi. Qëllimi kryesor i projektit është rritja e kontributit të KLSH-së për të forcuar llogaridhënien qeveritare në

përdorimin e fondeve publike përmes auditimeve më profesionale dhe gjithëpërfshirëse të prokurimeve publike, koncesioneve dhe partneriteteve publike-private, duke përdorur mjete IT në kryerjen e auditimeve financiare, përputhshmërisë dhe performancës në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat e mira profesionale për sektorin publik. Objektivi i përgjithshëm i projektit është të nxisë mbikëqyrjen publike dhe të rrisë cilësinë, transparencën dhe frenimin e korrupsionit në ofertat publike, koncesionet dhe partneritetet publike-private (PPP).

ANALIZA E OBJEKTIVAVE INSTITUCIONALE TË KLSH-SË, REFERUAR BUXHETIT TË ORIENTUAR NË REZULTATE PER PERIUDHEN E VITIT 2022

KLSH përgjatë vitit 2022 vijoi veprimtarinë menaxheriale institucionale suportuar nga një qeverisje e brendshme efektive dhe mirëfunksionimi të sistemeve të kontrollit të brendshëm duke siguruar përputhshmërinë me standardet e kontrollit të brendshëm me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përmbushjen e objektivave Strategjike në nivelin e pritshmërive të synuara drejt konsolidimit të reformave të ndërmarra, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI, me rekomandimet e Progres Raporteve të BE, me detyrimet kushtetuese dhe me pritshmërinë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit.

I. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E KLSH-së

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në katër nene të saj ka qartësisht të shprehur misionin dhe nivelin pavarësisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat formëzojnë identitetin institucional të tij. Ky mision dhe funksionimi institucional janë strukturuar dhe sanksionuar në detaje në Ligjin nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, mbi bazën e të cilave janë ndërtuar të gjitha aktet rregullative institucionale dhe metodologjike të institucionit.

Misioni i KLSH-së

Kontrolli i Lartë i Shtetit në cilësinë e institucionit më të lartë kushtetues të kontrollit ekonomik e financiar në vend, i ndërtuar që t’i shërbejë qytetarit shqiptar, ka si mision të tij të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Vizioni i KLSH-së

KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të pasurisë publike, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni, për të qenë vlerë e shtuar për shoqërinë dhe të sjellë ndryshim në jetën e qytetarëve.

Misioni dhe vizioni orientojnë mënyrën sesi institucioni duhet të performojë për të: garantuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin e qeverisë dhe njësive të tjera të sektorit publik; nxituri llogaridhënien para Parlamentit dhe rrituri transparencën për qytetarët; duke qenë një organizatë model që udhëheq nëpërmjet shembullit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, përmbush misionin dhe realizon veprimtarinë në zbatim të tetë parimeve: Pavarësia; Profesionalizmi; Bashkëpunimi; Përgjegjshmëria; Bashkëpunimi; Përgjegjshmëria; Integriteti; Objektiviteti; Interesi Publik; Transparenca

Zhvillimi i KLSH mbështetet në Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit të Institucionit të miratuar nga Kryetari KLSH, për periudhën 2018-2022.

Objektivat e KLSH-së

Përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022, objektivat e KLSH vijnë të jenë:

- Rritja e impaktit të punës audituese me fokus në 6 E-të (ekonomicitetin, eficiencën, efektivitetin, etikën, mjedisin dhe energjinë);
- Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse;
- Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit.

II. MBI VEPRIMTARINË AUDITUESE TË KLSH-së

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në cilësinë e institucionit më të lartë të auditimit të jashtëm publik, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për periudhën janar - dhjetor 2022, ka realizuar veprimtarinë audituese duke realizuar dhe evaduar **176 misione auditimi në 202 subjekte auditimi**. Në përmbushje të mandatit ligjor dhe objektivave strategjike institucionale, gjatë vitit 2022, KLSH ka zhvilluar auditime financiare, auditime të përputhshmërisë, auditime performance, auditime të sistemeve të teknologjisë dhe informacionit, dhe auditime të kombinuara. Gjatë vitit 2022, KLSH ka realizuar dhe detyrimin ligjor për auditimin dhe raportimin mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Gjithashtu, në përgjigje të vëmendjes së shtuar për çështje të veçanta, KLSH ka kryer dhe disa auditime tematike.

Në përfundim të misioneve të auditimit, bazuar në evidencën e auditimit dhe gjykimin profesional të audituesit është konkluduar me dhënien e Opinionit të Auditimit mbi pasqyrat financiare të subjektit të audituar dhe mbi përputhshmërinë e aktivitetit¹.

Auditimet kanë përfshirë institucione të qeverisjes qendrore: ministri dhe agjenci përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre²; njësi të vetëqeverisjes vendore: qarqe dhe bashki; institucione që administrojnë fonde speciale: ISSH dhe FSDKSH, institucione të pavarura; shoqëri aksionare me kapital shtetëror në të cilën shteti ka mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj.

Rezultatet e veprimtarisë audituese të vitit 2022 kanë pasur objektiv që krahas masave organizative për përmirësimin e situatës, edhe identifikimin e shkeljeve dhe raportimin e tyre në bazë të klasifikimit si dëm ekonomik³ dhe si parregullsi/paligjshmëri me efekte negative në financat publike nga aktiviteti i subjekteve nën auditim⁴. Parregullsitë dhe paligjshmëritë e konstatuara, i referohen:

-Përdorimit të fondeve jo me eficientë, efektivitet dhe ekonomicitet në fushën e prokurimit publik për shkak të mungesës së kontrollit në realizimin e këtyre procedurave, të cilat në shumë raste rezultojnë të kryera jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

-Shkelje të disiplinës buxhetore në programimin dhe realizimin e shpenzimeve publike, likuidimin e faturave për shpenzime/investime, i cili është shoqëruar me krijimin e

¹ Bazuar në Manualin e Auditimit Financiar dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë

² Drejtori të administrimit fiskal dhe doganor.

³ Dëmi ekonomik referohet detyrimit të shpërblyerit monetar të një individi ose subjekti që i shkaktohet entit shtetëror të audituar në lidhje me veprime ose mosveprime në cenim të disiplinës financiare dhe kuadrin rregullator përkatës.

⁴ Efekti negativ në performancën e subjekteve nën auditim i referohet efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimit me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike.

detyrimeve të prapambetura;

-Parregullsitë dhe shkeljet në administrimin e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore;

-Keqadministrimin e pronës shtetërore.

Informacion i detajuar mbi veprimtarinë e KLSH, jepet në Raportin Vjetor të Performancës së institucionit.

MBI ZHVILLIMIN E VAZHDUESHËM PROFESIONAL DHE FORCIMIT TË KAPACITETEVE TË TRUPËS AUDITUESE. TRAJNIMET E KRYERA

Treguesit kryesorë të zhvillimit profesional dhe trajnimit në KLSH -së për vitin 2022:

Mbi trajnimet e realizuara gjatë vitit 2022.

Referuar Plan-Veprimit mbi zbatimin e “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së” për vitin 2022, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.25 datë 04.02.2022, gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2022, janë zhvilluar trajnime me prezencë fizike dhe online në platformën Microsoft skype me stafin e KLSH-së, Ëëbinar dhe kurse online pranë ASPA-s, dhe trajnime (Ëërkshop, konferenca online, takime) me *Organizata/ Partnerë Ndërkombëtare* si më poshtë vijon:

Muaji Shkurt 2022: Trajnim mbi koncesionet dhe marrëveshjet e Partneritetit Publik-Privat (PPP), zhvilluar në datat 14-16 (grupi I) dhe 17- 18 (grupi II) Shkurt. Trajnimi u fokusua tek Legjislacioni shqiptar në fushën e PPP-ve, njohja e bazës ligjore dhe akteve rregullative si dhe *tek ISSAI 5220 “Udhëzime mbi praktikatat më të mira të auditimit të financimit privat/publik dhe koncesioneve & Kodi i Transparencës Fiskale, FMN.*

-Trajnim mbi Prokurimet Publike, zhvilluar në datat 22-23 (grupi I) dhe 24-25 (grupi II) Shkurt. Target grupi i trajnimit ishin audituesit në departamente auditimi me fokus tek Risetë e ligjit të ri të Prokurimit Publik, nr. 162/2020 dhe VKM-së nr.285 datë 19.05.2021. lidhur me objektin, konceptet, procedurat, dokumentat e tenderit, rregullat kualifikuese dhe s’kualifikuese, lidhja e kontratës me OE, ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, zgjidhjen e kësaj të fundit dhe hetimin administrativ.

Muaji Mars 2022: Trajnim online mbi Standardet e Auditimit dhe kornizën ligjore të KLSH-së, zhvilluar në datat 07-08-09 mars. Target grupi i këtij trajnimi ishin kategoria e parë e audituesve, të cilët duhet të realizojnë *25 ditë trajnimi në vit*, konkretisht, audituesit e rinj me eksperiencë, deri në një vit dhe audituesit e sapo rekrutuar. Trajnimi zgjati tre ditë dhe u fokusua tek kuadri rregullator i KLSH-së (*kushtetuta e RSH, neni 162-165 Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionit të KLSH-së*) njohuri të përgjithshme mbi aktet më të rëndësishme të Kornizës INTOSAI-t (*njohuri mbi Standardet e Auditimit, Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t”; ISSAI 100; 200; 300; 400 Njohuri mbi Standardet e Auditimit, niveli i III-të dhe i IV-t Manualit,udhëzuesit dhe praktikatat më të mira mbi të cilat mbështetet veprimtaria audituese në KLSH- ISSAI 2000; 3000; 4000*) dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit. Trajnimi u realizua nga Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit dhe u ndoq nga 14 auditues.

Muaji Prill 2022: Trajnim mbi Auditimin Financiar zhvilluar në datat 11-12 Prill. Target grupi i trajnimit ishin audituesit në departamente auditimi. Trajnimi zgjati dy ditë me dy grupe ndarë sipas departamenteve dhe u fokusua tek njohuri të përgjithshme mbi Auditimin Financiar; kuadrin ligjor mbi auditimin e Pasqyrave financiare të institucioneve publike; njohuri mbi Standardet ndërkombëtare të auditimit financiar dhe raportimit financiar, të INTOSAI (ISSAI/IFPP) standardet ISA të IFAC, auditimi i Pasqyrave Financiare dhe dhënia e opinionit të auditimit.

Trajnim mbi Auditimin e Performancës zhvilluar në datën 13 Prill. Target grupi i trajnimit ishin audituesit në departamente auditimi. Trajnimi u fokusua tek Manuali i Auditimit të

Performancës, miratuar me vendimin nr. 196 datë 26.11.2021; standartet e auditimit të performancës, etapat si zhvillohet një auditim performance dhe vecoritë e këtij të fundit krahasuar me auditime të tjera: planifikimi i auditimit; procedurat; dokumentimi; auditimi në terren dhe raportimi.

Trajnim mbi Udhëzuesin e Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit; (IFPP-140) “Kontrolli dhe Sigurimi i Cilësisë” dhe implementimin në praktikë zhvilluar në datat 14-15 Prill. Target grupi i trajnimit ishin audituesit/kryeaudituesit/drejtorë departamenti dhe drejtoria e Standarteve dhe Sigurimit të Cilësisë. Trajnimi zgjati dy ditë me dy grupe dhe u fokusua tek Udhëzuesi mbi menaxhimin e cilësisë në auditim (kontrolli, sigurimi, monitorimi i cilësisë), ISSAI/IFPP-140 “Cilësia në auditim” dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit, mbi hapat që duhet të ndiqen për kontrollin, sigurimin dhe monitorimin e cilësisë në auditim

Trajnim mbi Auditimin e Përputhshmërisë zhvilluar në datën 19 Prill. Target grupi i trajnimit ishin audituesit në departamente auditimi. Trajnimi u fokusua tek njohuri të përgjithshme mbi Auditimin e Përputhshmërisë; njohuri mbi standartet ndërkombëtare të auditimit të përputhshmërisë INTOSAI (ISSAI/IFPP) dhe IDI, manuali i Auditimit të Përputhshmërisë dhe llojet e opinioneve.

Trajnim mbi Manualin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve zhvilluar në datën 20 Prill. Target grupi i trajnimit ishin audituesit në departamente auditimi. Trajnimi u fokusua tek njohuri mbi qëllimin e manualit të auditimit të zbatimit të rekomandimeve, metodologjia dhe sistemi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, auditimi i zbatimit të rekomandimeve, raportimi i rezultateve dhe regjistri elektronik i zbatimit të rekomandimeve.

Muaji Maj 2022: Trajnim online mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT zhvilluar në datën 10 Maj. Target grupi i trajnimit ishin audituesit e departamentit të IT-së në KLSH dhe nga 3 auditues të përzgjedhur nga 5 departamente auditimi. Trajnimi u zhvillua brenda ditës dhe u fokusua tek njohuri lidhur me formën dhe përmbajtjen e Manualit Aktiv të Auditimit IT, që ka si objektiv kryesor vendosjen në praktikë të “Manualit ËGITA -IDI mbi Auditimin e IT-së për Institucionet Supreme të Auditimit”, duke ndihmuar audituesin me informacione thelbësore për të planifikuar një auditim të IT-së, mbledhjen e evidencave, raportimin dhe shkëmbimin e njohurive.

Muaji Qershor 2022: Trajnim online mbi GUID-5100 Udhëzues për auditimet e sistemeve të informacionit zhvilluar në datën 21 Qershor. Target grupi i trajnimit ishin audituesit e departamentit të IT-së. Trajnimi u zhvillua brenda ditës dhe u fokusua tek prezantimi i udhëzuesit 5100 “Mbi auditimet e sistemeve të informacionit”, për departamentin e IT-së, si një udhëzues i punës së tyre dhe orientim i kësaj të fundit kah praktikave më të mira.

Muaji Shtator 2022: Trajnim online për çështjet mjedisore, udhëzuesi për auditimin e çështjeve të mjedisit, si dhe problematikat në lidhje me lejet mjedisore dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis zhvilluar në datën 06 Shtator. Target grupi i trajnimit ishin audituesit e departamentit të aseteve, performances dhe nga 2 auditues për cdo departament auditimi. Trajnimi u fokusua tek legjislacioni shqiptar dhe aktet rregullative në fushën e mjedisit dhe IFPP-5201 “Auditimi mjedisit në kontekstin e auditimeve financiare dhe të përputhshmërisë” (udhëzues).

Trajnim online mbi kuadrin ligjor, nënligjor, rregullator në fushën e pasurive të paluajtshme, zhvilluar në datën 12 Shtator. Target grupi i trajnimit ishin audituesit e departamentit të aseteve dhe 2 auditues me profil jurist për cdo departament auditimi. Trajnimi u fokusua tek legjislacioni shqiptar dhe aktet rregullative në fushën e pasurive të paluajtshme, trajtim i çështjeve specifike në lidhje me regjistrimin e pasurive, ndryshimet që ka sjellë ligji i ri në këtë drejtim dhe problematikat kryesore të hasura në terren.

Muaji Tetor 2022: Trajnim online mbi auditimin e integritetit të punonjësve publikë zhvilluar në datën 14 Tetor. Target grupi i trajnimit ishin audituesit e rinj në periudhë prove. Trajnimi u zhvillua brenda ditës dhe u fokusua tek eksperiencat më të mira të SAI-eve

homologe, si dhe bazuar në Manualin e Vetëvlerësimit të Integritetit për Institucionet Supreme të Auditimit, auditimi i etikës në Organizatat e Sektorit Publik, si të implementojmë ISSAI 130 dhe Forcimi i Infrastrukturës Etike në SAI dhe Auditimi i Etikës në Sektorin Publik. Trajnim online mbi Standardet e Auditimit dhe kornizën ligjore të KLSH-së, zhvilluar në datat 17-18-19 Tetor. Target grupi i këtij trajnimi ishin kategoria e parë e audituesve, të cilët duhet të realizojnë 25 ditë trajnimi në vit, konkretisht, audituesit e rinj me eksperiencë, deri në një vit dhe audituesit e sapo rekrutuar. Trajnimi zgjati tre ditë dhe u fokusua tek kuadri rregullator i KLSH-së (*kushtetuta e RSH, neni 162-165 Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionit të KLSH-së*) njohuri të përgjithshme mbi aktet më të rëndësishme të Kornizës INTOSAI-t (*njohuri mbi Standardet e Auditimit, Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t”; ISSAI 100; 200; 300; 400 Njohuri mbi Standardet e Auditimit, niveli i III-të dhe i IV-t Manualit, udhëzuesit dhe praktikat më të mira mbi të cilat mbështetet veprimtaria audituese në KLSH- ISSAI 2000; 3000; 4000*) dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit. Trajnimi u realizua nga Drejtoria e Metodologjisë Trajnim me prezencë fizike në KLSH mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ/SDG), zhvilluar në datën 21 Tetor. Target grupi i trajnimit ishin dy auditues për cdo departament auditimi dhe Departamenti i Auditimit të Performancës. Trajnimi zgjati një ditë dhe u fokusua tek Deklarata e Shteteve Anëtare të OKB-së mbi OZHQ-të, që është "Transformimi i botës sonë: Axhenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm", roli i SAI-eve, i cili konsiston në kryerjen e një vlerësimi të pavarur të zbatimit të axhendës, në nxitjen e qeverive, për të vepruar aty ku nuk janë ndërmarrë veprime, në rritjen e gatishmërisë dhe zbatimin e Agjendës 2030, si dhe në rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe palëve të interesuara për rëndësinë e zbatimit të Agjendës 2030, dhe njohja me standardet ISSAI/IFPP 5202 “Zhvillimi i Qëndrueshëm: Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit” dhe Udhëzuesin “ISAM”, i publikuar nga INTOSAI/IDI, mbi auditimin e OZHQ-ve.

Trajnim online mbi bazën ligjore të hartimit, monitorimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit. Hartimi i Raportit të Zbatimit Buxhetit të Shtetit, praktikat më të mira, zhvilluar në datën 31 Tetor. Target grupi i trajnimit ishin pesë auditues nga pesë departamente auditimi. Trajnimi u fokusua tek baza ligjore e hartimit, monitorimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit dhe hartimi i Raportit të Zbatimit Buxhetit të Shtetit.

Muaji Nëntor 2022: Trajnim online mbi Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH me fokus hartimin e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimit zhvilluar në datën 02 Nëntor. Target grupi i këtij trajnimi ishin pesë auditues nga cdo departament auditimi. Trajnimi u fokusua tek procedurat e realizimit të një projekt auditimi, standardizimi i tyre dhe nxjerrja e produkteve të unifikuara për nga forma. Trajtimi i fazës së raportimit, hartimi i Projekt raportit dhe Raportit përfundimtar të Auditimit, raste konkrete (shembuj praktikë).

Trajnim mbi korrupsionin, roli i KLSH, me prezencë fizike dhe online, zhvilluar në datat 14-15-16 Nëntor. Target grupi i këtij trajnimi ishin të gjithë audituesit në departamentet e auditimit. Trajnimi u fokusua në ISSAI/IFPP 5270 “Udhëzues për Auditimin e Parandalimit të Korrupsionit”.

Trajnim online mbi sistemin RevZone, zhvilluar në datat 23-24-25 Nëntor. Target grupi i këtij trajnimi ishin të gjithë audituesit në departamentet e auditimit dhe u fokusua në njohuri mbi sistemin RevZone dhe Rregulloren e funksionimit të sistemit të informacionit për menaxhimin e proceseve të auditimit dhe administrative (RevZone) në KLSH.

Muaji Dhjetor 2022: Trajnim 2 ditor mbi çështjet drejtshkimore dhe formatin e shkresave në administratën publike, zhvilluar në datat 13-14 Dhjetor. Target grupi i këtij trajnimi ishin 5 Auditues nga cdo departament auditimi si dhe sektori financës dhe protokoll-arkivës dhe 2 auditues nga Departamenti juridik dhe Drejtoria e Standardeve dhe Cilësisë.

Trajnim 1 ditor mbi Sigurinë e Informacionit dhe krimi kibernetik, zhvilluar në datë 19 Dhjetor. Target grupi i këtij trajnimi ishin audituesit e Departamentit të IT-së dhe 5 auditues nga cdo departament auditimi.

Referuar trajnimeve të brendshme në KLSH bazuar në Programin e Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së” për vitin 2022, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.25 datë 04.02.2022 dhe Plan-Veprimet në zbatim të këtij të fundit, vlen të përmendim se gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, janë 152 auditues në KLSH që kanë marrë pjesë në mënyrë të koordinuar në 21 tema trajnimesh të shtrira në 38 ditë (referuar tabelës nr.1) dhe kanë realizuar një numër prej 1402 ditë/auditues trajnimi.

Krahas trajnimeve të Brendshme KLSH ka vijuar edhe për vitin 2022 bashkëpunimin e saj me Shkollën e Administratës Publike (ASP) duke përcjellë elektronikisht përgjatë muajve janar-tetor 2022 kalendarët e trajnimeve online (Ëëbina dhe kurse online) tek stafi i KLSH-së. Shpërndarja e trajnimeve bëhet duke patur parasysh formimin e audituesve, por veçanërisht angazhimin e tyre varësisht departamenteve ku janë pjesë. Tematikat që dominojnë janë: Prokurimi publik, Ligji për nëpunësin civil dhe të drejtën administrative, Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli, Auditimi Brendshëm, Vetëqeverisja vendore, E drejta Europiane, Fondet IPA, Siguria e Informacionit, komunikimi, etika dhe niveli menaxherial, programi i kontrollit dhe cilësisë në auditim, auditimi publik, kontabiliteti dhe statistikët etj. Në kuadër të trajnimeve online për periudhën janar-dhjetor 2022 kanë ndjekur Ëëbina dhe kurse online me certifikim në ASPA rreth 111 auditues në departamente auditimi që kanë realizuar një numër prej 1720 ditë/auditues trajnimi. Risi e këtij viti kanë qënë trajnimet e ASPA-S për muajt Shkurt-Mars lidhur me asistencën brenda administratës publike për subjektet e deklaratimit të pasurive, trajnimet për muajin Prill të dedikuara për procedurat e taksimit mbi pasuritë e paluajtshme, për muajin maj lidhur me procesin e zgjerimit të BE-së përmbledhje në këndvështrimin e parimeve dhe institucioneve, për muajin Qershor përmendim trajnimet e dedikuara në fushën e problematikave mjedisore dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit publik në respektim të aspekteve mjedisore dhe për muajin Tetor trajnimi mbi etiketimin e ushqimit dhe informimin e konsumatorit.

Lidhur me aktivitetet e zhvilluara me organizata të huaja (ndërkombëtare dhe rajonale) gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, janë 100 auditues në KLSH kanë marrë pjesë në mënyrë të koordinuar në 28 aktivitete të shtrira në 129 ditë dhe kanë realizuar një numër prej 768 ditë/auditues trajnimi.

Trajnime individuale janë ndjekur nga 5 persona/staf auditues, të cilët kanë realizuar 15 ditë/auditues trajnimi individuale në kuadër të rritjes tyre profesionale.

Indikatori i trajnimeve. Në Rregulloren e brendshme mbi Organizimin dhe funksionimin e KLSH, miratuar me vendimin 197 datë 12.10.2022, Strategjinë për Zhvillim Institucional 2018-2022, si dhe në Programin e Zhvillimit të Integruar Profesional të miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 25, datë 04.02.2022, është miratuar indikatori 25 ditë/trajnime në vit për çdo auditues.

Siç shihet nga të dhënat, trupa audituese e KLSH-së, gjatë vitit 2022, ka realizuar 26.5 ditë trajnimi/auditues, nga 25 ditë trajnimi/auditues të planifikuara, ku nga audituesit e rinj janë kryer 15.24 ditë mesatare trajnimi. Ky tregues është realizuar në masën 106 % kundrejt objektivit.


Trajtimi i ankesave të qytetarëve

Kontrolli i Lartë i Shtetit vijon të shqyrtoj me korrektësi dhe profesionalizëm të gjitha ankesat, denoncimet dhe kërkesat për informacion të ardhura nga qytetarët dhe media të ndryshme. Gjatë vitit 2022 në Kontrollin e Lartë të Shtetit janë administruar në total 340

ankesa dhe denoncime, të cilat 281 prej tyre kanë qenë ankesa dhe 59 janë denoncime të ardhura nga portali në Eëbsite-n e KLSH. Fushat kryesore në të cilat qytetarët kanë ngritur shqetësimin e tyre lidhen kryesisht me:

- administrimin dhe kthimin e pronës,
- administrimin financiar dhe procedurat e prokurimit në administratë
- llogaritjen e pensioneve etj.

Programi i Transparencës Në mbështetje të Ligjit Nr. 119/2014 për të Drejtën e Informimit, në Kontrollin e Lartë të Shtetit janë administruar 63 kërkesa për informacion, të cilat kanë marrë përgjigje brenda afateve ligjore. Gjithashtu, sipas nenit 8 të ligjit nr. 119/2014 në Eëbsite-n e KLSH është publikuar dhe regjistri i kërkesave për informacion si dhe përgjigjet e tyre, duke u azhurnuar në mënyrë periodike.



Kërkesa për informacion kanë qenë kryesisht kërkesa mbi vënien në dispozicion të raporteve përfundimtare të auditimit të kryera nga KLSH si dhe pyetsorë lidhur me veprimtarinë audituese të KLSH. Në Kontrollin e Lartë të Shtetit janë depozituar:

- 4 kërkesa për informacion nga deputetë të Kuvendit, në të cilën janë vënë në dispozicion 36 raporte përfundimtare auditimi,
- 10 kërkesa për informacion kanë ardhur nga gazetarë dhe përfaqësues të medias,
- 49 kërkesa për informacion të ardhura nga qytetarë

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Valbona GAXHA

Viti 2022

Në 000/lekë

Përgjegjës Sektori Finance	Alketa Kallëshi	Sekretari i Përgjithshëm	Valbona Gaxha
	Firma		Firma
	Data		Data

Viti 2022

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

Kontrolli i Lartë i Shtetit			Kodi i Grupit	
Programi	Programi Veprimtari Audituese e KLSH		Kodi i Programit	
			1024001	01120

Nw 000/lekë

Artikulli	Programi	Fakti Paraardhës Viti 2021	PBA Viti 2022	Plan Fillestar Viti-2022	Plan i Rishikuar Viti 2022	Plan i Rishikuar Viti 2022	Fakti Viti 2022	Diferenca
600	Paga	247,281	269,000	319,000	311,025	294,025	290,957	-3,068
601	Sigurime Shoqërore	40,073	42,000	42,000	40,950	47,950	47,126	-824
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	51,593	103,960	103,810	93,429	82,729	69,485	-13,244
605	Transferta Korente të Huaja	61		150	150	150	119	-31
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,273		1,600	1,600	2,600	2,554	-46
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	340,281	414,960	466,560	447,154	427,454	410,241	-17,213
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	7,586	15,000	20,000	20,000	20,000	17,323	-2,677
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	7,586	15,000	20,000	20,000	20,000	17,323	-2,677
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	1,115		24,000	24,000	24,000		-24,000
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	1,115	0	24,000	24,000	24,000	0	-24,000
Totali	Shpenzime Kapitale	8,701	15,000	44,000	44,000	44,000	17,323	-26,677
	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti						0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		348,982	429,960	510,560	491,154	471,454	427,564	-43,890

Pergjegjes	Alketa Kalleshi	Sekretari i Përgjithshëm	
Sektori	Firma		
Finance	Data		
		Valbona Gaxha	
		Firma	
		Data	



ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të kërkesave të performancës/produtiveve të programit"

Emri i Grupit	Kontrolli i Lartë i Shëtit	Kodi i Grupit
Programi	Programi Veprimtari Audituese e KLSH	Kodi i Programit
		1024001 01120

Viti 2022

Kodi	Emertimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Sasia Faktike Viti 2021	Shpenzimet (Viti 2021)	Kosto per Njesi (Viti 2021)	Sasia (sipas planit Viti 2022)	Shpenzimet (sipas planit te vitit 2022)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III
A	Auditime te kryera	nr 158	340,281	2,154	165	447,154	2,710	176	427,454	2,429	17	410,240	24,132	21,978	21,422	21,703
B	Blerje pajisje kompjuterike	nr 212	3,556	17	20	3,000	150	20	3,000	150	20	2,580	129	112	-21	-21
C	Blerje pajisje zyre	nr 4	310	78	22	700	324	47	700	41	17	668	39	-38	7	-2
D	Blerje Automjete	nr			1	9,700	9,700	1	9,700	9,700	1	8,580	8,580	8,580	-1,120	-1,120
G	Kosto Lokale	nr 1	2,300		2	5,000	2,500	1	5,000	5,000	1	4,291	4,291	4,291	1,791	-709
H	Rikonstrukcion Ndertesa	nr 1	1,420		1	1,600	1,600	1	1,600	1,600	1	1,203	1,203	1,203	-397	-397

Pergjegjes
Sektori
Finance

Albena Kalli
Firma
Data

Valbona Gaxho
Firma
Data

Sekretari i Pergjithshem

18.02.2023

Viti 2022

ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit"

Kodi i Programit	1024001	Emertimi i programit:	Veprimtari Auditueses e Kontrollit te Larte te Shtetit						
Qellimi 1	" Ushtrimi i veprimtarise audituese ne nje linje me standardet nderkombetare te auditimit mbi perdorimin me efektivitet, effcence dhe ekonomicitet te fondeve publike ne funksion te rritjes se pergjegjshmerise se menaxhimit te financave e pasurise publike duke sjelle vlere te situar per shoqerine dhe ndryshim ne jeten e qytetareve"								
			**Treguesit e performancës/Produktet:						
	Objektivat e politikës	Kodi i Treguesit te Performances/Produkti	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produkti	Niveli faktik i vitit 2021	Niveli i planifikuar ne vitin 2022	Niveli i rishikuar ne vitin 2022	Niveli faktik ne fund te periudhes	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1.	“Mbulimi me auditime financiare perputhshmerie dhe performance i njeseve te sektorit publik nepermjet konsolidimit te auditimeve te perputhshmerise rritjes se auditimeve financiare dhe te performances ne nje linje me Standardet Nderkombetare te Auditimit ISSAI”	A	Auditime te kryera	158	165	165	176	107%	
Objektivi 1,1	Ofrimi i kushteve cilësore të punës për zhvillimin e aktivitetit auditues të KLSH-së nëpërmjet investimit për ngritjen e godinës dhe përmirësimin e infrastrukturës akomoduese me paisje dhe orëndi të nevojshme, në funksion të ushtrimit normal të veprimtarisë institucionale.								
		B	Blerje paisje kompjuterike	212	20	20	20	100%	
		C	Blerje paisje zyre	4	17	17	17	100%	
		D	Blerje Automjete	0	1	1	1	100%	
		G	Kosto Lokale	1	1	1	1	100%	
		H	Rikonstruksjon Ndertesa	1	1	1	1	100%	

Përgjegjesi Sektori Finance	Alketa Kafeshti	Sekretari i Përgjithshëm	Valbona Gaxha	
	Firma			Firma
	Data			Data
			28.02.2023	

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Viti 2022

Projektet me financim te brendshem (ne 000/leke)

Emri i Grupit	Kontrolli i Larte i Shtetit	Kodi i Grupit
Programi	Programi Veprimtari Audituese e KLSH	01120

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e Projektit.	Viti i fillimit te Projektit	Viti i përfundimit te Projektit	Buxheti 2022 Kontraktuar.	Plani i buxhetit viti 2022	Realizimi Progressiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Realizimi për periudhën e raportimit	Realizimi Progressiv nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	Komente
M240002	Blerje automjete	9,700	2022	2022	9,700	8,700	8,580	8,580	8,580	
M240009	Blerje pajisje kompjuterike	3,000	2022	2022	3,000	3,000	2,580	2,580	2,580	
M240003	Rikonstruksion Godina	1,600	2022	2022	1,600	1,600	1,203	1,203	1,203	
M240010	Blerje pajisje zyre	700	2022	2022	700	700	668	668	668	
19AA402	Kosto Lokale	5,000	2022	2022	5,000	6,000	4,291	4,291	4,291	
		20,000			20,000	20,000	17,322	17,322	17,322	0

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant	Vlera e plotë e Projektit.	Viti i fillimit te Projektit	Viti i përfundimit te Projektit	Buxheti i Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2022.	Realizimi për periudhën e raportimit	Realizimi Progressiv nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	Realizimi Progressiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale
19AA401	Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri	Grant/	24519	2022	2023	0	24000	0	0	0

Pergjegjesi Sektori Finance	Emri	Alketa Kalleshi	Emri	Valbona Gaxha
	Firma	<i>[Signature]</i>	Firma	<i>[Signature]</i>
	Data	28.02.2023	Data	28.02.2023